

# NJOFTIM MBI ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

*Në përputhje me nenin 47 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)*

Data: 12.09.2025

**I.** “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”  
Adresa: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë

**II.** Lënda e procedurës së prokurimit:

**II.1** Titulli i kontratës: “**Furnizimi me makina procesuese të kartëmonedhave dhe furnizimi me module të lidhjes**” (2 pjesë/Lot)

**II.2** Numërtimi i prokurimit: “BQK 25 007 111”

**II.3** Lloji i procedurës: *Procedurë e hapur*

**II.4** Lloji i prokurimit: Furnizim

**II.5** Numri i tenderëve të pranuar:

Pjesa/Lot 1: 3 (tre) ofertues; dhe

Pjesa/Lot 2: 0 (zero) ofertues

**III.** Anulimi i procedurës së prokurimit:

**III.1** Data e anulimit të procedurës: 12.09.2025

**III.2** Anulimi i kësaj procedure të prokurimit bëhet në përputhje me Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore, nenin 47, paragrafët 1, 2 dhe 3. Kjo Rregull përbën bazën ligjore të udhëheqjes së procedurës së prokurimit, referuar edhe Dosjes së këtij tenderi me nr. të Prokurimit: “BQK 25 007 111”

Anulimi i procedurës është në pajtim me parimet e prokurimit të përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulle dhe ka për qëllim shmangien e ekspozimit ndaj rrezikut të vlerësuar reputacional dhe ligjor. Anulimi gjithashtu është në harmoni me parimet e ligjshmërisë të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**III.3.** Takim me palët e interesuara (tenderuesit)

Tenderuesi mund të paraqesin kërkesë për takim informues brenda pesë (5) ditëve nga data e pranimit të këtij njoftimi. Takimet do të zhvillohen në ambientet e Bankës Qendrore dhe do të kenë karakter sqarues.

#### IV. Ankesat

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024), respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar<sup>1</sup> mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

---

<sup>1</sup> “Palë e interesuar”, sipas pikës 1.26 të nenit 2 të “Rregullës për Prokurimin në BQK” cilësohet operatori ekonomik që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.